



GENTA REXHA

PROF. ASOC. DR.

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I KARRIERËS

Prof. Asoc. Dr. Genta Rexha është lektore në Departamentin e Shkencave të Aplikuara dhe Kompjuterike

FUSHA E EKSPERTIZËS KËRKIMORE

- Studimet e saj kërkimore shkencore fokusohen në nanomateriale, sensorë dhe standardizim

EMAIL

g.rexha@umb.edu.al

BIO

Prof. Asoc. Dr. Genta Rexha është diplomuar në vitin 2007 në Universitetin e Dytë të Napolit, Itali, në “Inxhinieri Aerohapësinore”. Në vitin 2010, ka fituar në këtë Universitet gradën shkencore “Doktor” në “Shkenca dhe Teknologji Aerohapësinore”.

Nga fundi i vitit 2010 deri në Qershor 2011, ka punuar në Institutin e Motorrave në Napoli, pjesë e Këshillit Kombëtar të Kërkimit Shkencor në Itali. Nga viti 2011, është angazhuar si lektore me kohë të plotë/të pjesshme në universitete të ndryshme private dhe publike në Shqipëri. Nga viti 2019, është angazhuar si vlerësuese e jashtme pranë ASCAL.

Në vitin 2021, fiton titullin akademik “Profesor i asociuar” nga Universiteti Politeknik i Tiranës.

Gjatë karrierës së saj akademike, i ka kushtuar vëmendje dhe angazhim të veçantë ndërkombëtarizimit dhe ngritjes së partneriteteve duke u bërë pjesë e një sërë projektesh në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar për ngritjen e kapaciteteve, shkëmbimeve, kërkimit shkencor etj.